

## Çfarë është Instituti Parlamentar?

Instituti Parlamentar (IP) është një shërbim i veçantë në administratën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të deputetëve në ushtrimin e funksioneve të tyre përfaqësuese, ligjvënëse, dhe mbikëqyrëse. Instituti ka si qëllim të mbështesë vendimmarrje të mirë-informuar përmes ofrimit të informacionit dhe produkteve kërkimore, si edhe zbatimit të programeve të edukimit qytetar.

Krijimi i Institutit Parlamentar është bazuar në praktikat më të mira nga Shërbimi i Kërkimit në Kongresin e SHBA, në Parlamentin Europian, si edhe në Institutet Parlamentare të Republikës Çeke, Sllovakisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut.

## Instituti përbëhet nga tre shërbime



### Shërbimi i Kërkimit dhe Analizës

ofron produkte kërkimore objektive, koherente, të besueshme, dhe në kohë, përfshirë këtu informacione, analiza, dhe studime për deputetët.



### Shërbimi i Bibliotekës dhe Publikimeve

mundëson përdorimin efikas të librave, revistave dhe dokumenteve; ofron informacion për referencë ose për tu përdorur nga deputetët, stafi i kuvendit, dhe qytetarët; përgatit një sërë publikimesh lidhur me aktivitetin parlamentar.



### Shërbimi i Edukimit Qytetar

krijon dhe zbaton programe të cilat informojnë dhe edukojnë qytetarët në lidhje me demokracinë dhe qeverisjen, si edhe nxit qytetarët të jenë aktiv në punën e Kuvendit

## Puna e IP bazohet mbi parimet e:

objektivitetit


paanësisë

koherencës

besueshmërisë


transparencës

## Organet e Institutit



### Këshill Drejtues do të vëzhgojë punën e IP

Është i përbërë nga perfaqësues të të gjitha grupeve parlamentare. Përfaqësues të NDI dhe SDC do të jenë pjesë e Këshillit Drejtues si vëzhgues.



### Bord këshillimi

ofron drejtuesve të IP si edhe anëtarëve të Këshillit Drejtues këshillim dhe udhëzim strategjik.

Është i përbërë nga ekspertë lokal dhe ndërkombëtarë në fushën e kërkimit parlamentar dhe edukimit qytetar dhe do të krijohet me mbështetjen e NDI.